Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së

parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Date _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	6	7
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi/muaj	Çmimi total per 12 muaj Lekë pa TVSH (4 x 5)	Afati
1.	Shërbim Primar Internkoneksioni për Zyrën Qendrore Identitek	muaj	1 zyrë			12 muaj
2.	Shërbim Primar Internkoneksioni për Zyrat e Aplikimeve Identitek	muaj	115 zyra			12 muaj
Fondi limit i marrëveshjes kuadër					21,773,156 lekë pa TVSH	
		Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH						

TVSH (%)		
Çmimi total me TVSH:		
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit		
Nënshkrimi		
Vula		
Datë _____		

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si

konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“Sigurim i shërbimit Primar të Interkoneksionit për Trasmetimin e të dhënave sensitive biometrike për Zyrën Qëndrore Identitek dhe Zyrat e Aplikimeve”

1. Qëllimi

IDENTITEK” SH.A. është një shoqëri me kapital 100% shtetëror, me objekt veprimtarie prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit (ID) dhe pasaportave biometrike për shtetasit shqiptarë. Në mënyrë që të garantojë këtë veprimtari është e rëndësishme që të sigurojë një shërbim të përsosur dhe të sigurtë Linje primare internet dhe intranet për Zyrën Qëndrore dhe Zyrat e Aplikimeve.

2. Përshkrimi i Shërbimit të kërkuar

Identitek sha kërkon që të gjithë operatorët që do të marrin pjesë në procedurën konkurruese duhet të plotësojnë një sërë kushtesh teknike për ofrimin e shërbimit sipas kritereve të mëposhtme:

Nr.	Lloji i Shërbimit	Përshkrimi	Sasia	Afati Kohor
1.	Shërbim Primar Internkoneksioni për Zyrën Qëndrore Identitek	Sherbim Interneti i Dedikuar Primar me ASN dhe IP Publike të dedikuar	1	1 Vjekar
2.	Shërbim Primar Internkoneksioni për Zyrat e Aplikimeve Identitek	Shërbim Primar Intranet Data	115	1 Vjekar

Kërkesat janë të bazuara në Standardet Europiane dhe ato ndërkombëtare për Rrjetin dhe Komunikimin.

3. Operatori duhet të garantojë dhe të ofrojë:

Mëposhtë paraqitet një skemë konceptuale e zgjidhjes shumë funksionale për Zyrën Qëndrore:




Figure 1 Skema konceptuale e zgjidhjes për Zyrën Qëndrore

4. Përshkrimi Funkcional i zgjidhjes që Operatori duhet të ofrojë:

a. Shërbim Primar Interneti për Zyrën Qëndrore Identitek

Linje e Dedikuar e Internetit për Zyrën Qëndrore Identitek “Dual Homed”

Identitek kërkon shërbim interneti të dedikuar dhe me kapacitet Donwload dhe Upload Simetrik 300 Mbps / 300 Mbps, me CIR 99,95 %. Linja do të jetë e dedikuar vetëm për klientin dhe do të jetë në monitorim nga Sistemet të Menaxhimit të Rrjetit, duke siguruar një cilësi shërbimi SLA (Service Level Agreement) dhe mbështetje proaktive në rast degradimi apo defektesh.

Për të mundur lidhjen, ofruesi do të sigurojë lidhjen midis Identitek dhe rrjetit të tij duke përdorur teknologjinë e fibrave optike.

Lidhja do të mbrohet, duke krijuar lidhje nga dy pika të ndryshme prezence (PoP) në konceptin “Dual Homed”.

Të dyja lidhjet do të realizohen nga pika në pikë nga pika e pranisë së ofruesit në ambientet e Identitek por në drejtime të ndryshme duke garantuar kështu disponueshmërinë në rast defektesh apo dëmtimesh fizike. Lidhja e parë do të qëndrojë aktive gjatë gjithë kohës dhe në rast problemesh lidhja e dytë do të kalojë në linjë aktive. Kalimi nga linja aktive në linjën e gatishmërisë do të bëhet në mënyrë automatike duke përdorur pajisjen switch inteligjent të menaxhueshëm të operatorit.

Kriteret Teknike për shërbimin e Internetit në Zyrat Qëndrore:

- Lidhje e Dedikuar me Fibër Optike Dual Path Redundant deri në Rack Kabinet
- Terminimi në Zyrat Qëndrore të Identitek duhet të plotësojë:
- Ndërfaqe të vetme GBE për rrjetin LAN të Identitek
- Konfigurimi duhet të jetë me Vlan të dedikuar

- Class IP Publike Reale me kapacitet X.X.X.X/26
- Kapacitet Simetrik Donwload dhe Upload Minimalisht 300 Mbps/300 Mbps, dhe me disponueshmëri CIR 99,95 %.
- ASN e Ndryshme nga Shërbimi Backup
- Operatori ekonomik duhet të mundësojë për shërbimin:
 - Grafikë dhe raporte në kohë reale të trafikut në rrjet
 - Monitorim të protokolleve në rrjet
 - Njoftime automatike dhe alarmistike sipas templateve të konfigurueshme edhe nga vetë AK
 - Dashboarde të përdorimit të shërbimit të konfigurueshme edhe nga vetë AK
 - Vendosje të objektivave të shërbimit dhe parametrave threshold me qëllim përcaktimin dhe monitorimin e Service Level Agreement
 - Raportim online të performancës së shërbimit në rrjet dhe SLA
 - Mundësi për përdorim të protokolleve SNMP, Netflow, sFlow për monitorimin e performancës së shërbimeve në rrjet
 - Mbrojtje të rrjetit të AK përmes parandalimit të ndërhyrjeve nga sulmet DOS dhe DDOS

Implementimi i DNSSEC: ISP-ja duhet të zbatojë DNSSEC në të gjitha serverat DNS që trajtojnë kërkesat e DNS të Identitek, duke siguruar validimin e përgjigjeve DNS dhe mbrojtje nga sulmet si spoofing apo ndërhyrjet në komunikim.

b. Shërbim Primar Intranet Data për Zyrat e Aplikimit

Linjë e Dedikuar shërbim Intranet Data me PBR Automatic Falover për Zyrat e Aplikimit

Ofruesi në po të njëjtën linjë të dedikuar me Zyrën Qëndrore duhet të ofrojë një zgjidhje Shërbim Intranet Data dhe të mundësojë nëpërmjet rrjetit të tij me cilësi të lartë dhe akses me zgjerueshmëri të mjaftueshme për të gjithë Zyrat aktuale të Aplikimit por edhe për ato Zyra që do të mund të shtohen në të ardhmen dhe pavarësisht vendndodhjes, duke garantuar komunikim dhe shërbim data me Zyrën Qëndrore të Identitek.

- **115 Zyra Aplikimi, Regjistrimi dhe Shpërndarje: Kryejnë mbledhjen e aplikimeve të të dhënave biometrike dhe Shpërndarjen e Dokumentave Biometrike në të gjithë territorin e Shqipërisë**
 - Pasqyra gjeografike e shpërndarjes së Zyrave të Aplikimit



Mëposhtë po ju paraqesim tabelën me adresat e Zyrave të Aplikimit:

Nr.	Emri i Zyrës	Adresa	Kodi i Zyrës
1	Bashkia Berat	'Lagja 30 Dhjetori, Stadiumi i Ri, Berat	2
2	Bashkia Ura Vajguore	'Rr.Dimal, Lagja 18 Tetori, Kodi Postar 5007, Ura Vajguore	5
3	Bashkia Kuçovë	'Lagja Nr. 1, Blloku, Tafil Skendo,Nr.11, Kuçovë	17
4	Bashkia Çorovodë	Shehi "Sina Leshnja"	21
5	Bashkia Poliçan	'Lagjia Qendër, Rr. Miqësia, Nd. Nr.17, H.1, Poliçan	22
6	Bashkia Peshkopi	'Lagja "Nazmi Rushiti", Blv."Elez Isufi", Nd. Prefekturës, Kt.1, Peshkopi	32
7	Njësia Adm. Maqellarë	'Njësia Administrative Maqellarë, Ish-Gjimnazi Maqellarë	40
8	Bashkia Burrel	'Sheshi " Kastriotët", Nd.Nr.1, Burrel	48
9	Bashkia Klos	'Lagja nr.2, Rruga "Jaho Hoxha", Nd.Nr.2,H.2, Klos	49

10	Bashkia Bulqizë	'Rr. Unazës, Lagja "Minatori", Kodi Postar 8401, Bulqizë	61
11	Bashkia Durrës R 03	'Lagja Nr.5, Rr. Kadri Pirro, Nd.Nr.20, Kodi Postar 2004, Durrës	72
12	Bashkia Durrës R 04	'Rr. Aleksander Goga,Rrugica Mitrush Kuteli, Lagjia. 8, Kodi Postar 2003, Durrës	73
13	Bashkia Durrës R 05	'Lagja Nr. 17, Rr. Dalip Peza, Nd.32, H.1,Kodi Postar 2002, Durrës	74
14	Bashkia Durrës R 06	'Lagja 14, Rr. Kripa e Detit, Nd.84,Kodi Postar 2009, Durrës	741
15	Njësia Adm. Sukth	'Rr. "Hekurudha", Kodi Postar 2010, Sukth, Durrës	76
16	Njësia Adm. Xhafzotaj	'Rr. "4 Rrugët Shijak", Kodi Postar 2019, Xhafzotaj, Shijak, Durrës	83
17	Bashkia Krujë	'Lagja Nr.1, Rruga Skënderbej,Qendër, Krujë	85
18	Njësia Adm. Fushë-Krujë	'Lagja Kastrioti, Rruga e Gjmnazit, Fushë-Krujë	86
19	Bashkia Elbasan	'Rr. Rinia, Lagja Kala, Elbasan	92
20	Bashkia Cërrik	'Lagja Nr:2, Rruga "Gjmnazi" 1962, Cërrik	97
21	Bashkia Belsh	'Qendër,Belsh	98
22	Bashkia Gramsh	'Sheshi "Kamber Dermynshi", Rruga 10 Korriku, Gramsh	120
23	Bashkia Peqin	'Blv. "Mustafa Gjinishi", Peqin	131
24	Bashkia Librazhd	'Sheshi "Gjorg Golemi", Librazhd	138
25	Bashkia Prrenjas	'Rruga "Skënderbe", Prrenjas	139
26	Bashkia Fier	'Rr. Harrilla Bozdo. Lagjia 15 Tetori, ish Stacioni i Trenit, Fier	150
27	Bashkia Patos	'Ndërmarrja e Ujësllësit, Patos	154
28	Bashkia Roskovec	'Lagja Nr. 2, Rr. Ymer Pirra, Ndërtesa 11/1, Roskovec	155
29	Bashkia Lushnje	'Rr. Uan Kondakciu, Lagja Loni Dharmo, Lushnje	171
30	Bashkia Divjakë	'Sheshi "Santa Barbara", Qendër Divjakë	173
31	Njësia Adm. Fier-Shegan	'Rruga Nacionale "Lushnje-Berat", Kilometri i 9, Qendër Fier-Shegan	178
32	Bashkia Ballsh	'Rruga "Rrapo Hekali", Ballsh, Mallakastër	189
33	Bashkia Gjirokastër	'Rruga Ismail Kadare, Gjirokastër	199
34	Bashkia Tepelenë	'Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë	213
35	Bashkia Përmet	'Sheshi "Abdyl Frashëri", Përmet	224
36	Bashkia Korçë	'Blv. Shën Gjergji, Lagjia 12, Korçë	234
37	Bashkia Maliq	'Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë	238
38	Njësia Adm. Qendër-Korçë	'Qendër Bulgarec,Korçë	248
39	Bashkia Ersekë	'Sheshi "Rilindja", Ersekë	254
40	Bashkia Pogradec	'Blv. "Europa", Pogradec	263
41	Njësia Adm. Buçimas	'Komuna Buçimas, Pogradec	264
42	Bashkia Bilisht	'Lagja nr.1 Rruga "24 Tetori" nr.07, Bilisht	272
43	Bashkia Kukës	'Sheshi "Skënderbej", Pallati i Kultures "Hasan Prishtina", Kukës	278
44	Bashkia Krumë	'Sheshi "Luan Haradinaj", Krumë, Has	294
45	Bashkia B. Curri	'Sheshi "Azem Hajdari", Bashkia Bajram Curri	299
46	Bashkia Lezhë	'Pallati i Rindërtimit, Lagjia Besëlidhja, Lezhë	308
47	Njësia Adm. Shënkoll	'Rruga Shënkolli, Lezhë	316
48	Bashkia Rrëshen	'Sheshi " Abat Doci", ish SHIKU, Rrëshen, Mirditë	319
49	Bashkia Laç	'Pallati i Kulturës "Kok Malçi", Sheshi "Gjin Pjetri", Laç	327

50	Njësia Adm. Mamurras	'Rruga " Teuta", Mamurras	328
51	Bashkia Shkodër	'Rr. 13 Dhjetori, Shkodër	332
52	Bashkia Vau i Dejës	'Rruga: "Qafa e Gurit", Vau i Dejës, Shkodër	336
53	Njësia Adm. Bushat	'Komuna Bushat, Shkodër	338
54	Njësia Adm. Postribë	'Komuna Postribë, Shkodër	344
55	Bashkia Pukë	'Sheshi "Gjergj Kastrioti" , Pukë	354
56	Bashkia Koplik	'Rruga "Qëndër", Koplik	365
57	Bashkia Tiranë T 01	'Rr. Hodo Beg, Tiranë	373
58	Bashkia Tiranë T 02	'Rr. Petro Nini Luarasi, Njësia Bashkiake Nr.2, Tiranë	374
59	Bashkia Tiranë T 03 - T 04	'Rr. Ali Baushi, Tiranë	375
60	Bashkia Tiranë T 05	'Rr. Robert Shvarts, Tiranë	377
61	Bashkia Tiranë T 13 - K. Diellit	'Rr. Rrapo Hekali - Lagja 13 - Kodra e Diellit, Tiranë	3771
62	Bashkia Tiranë T 06	'Sheshi Garibaldi, Kombinat, Tiranë	378
63	Bashkia Tiranë T 07	'Rr. Shefquet Musaraj 3, Tiranë	379
64	Bashkia Tiranë T 08 - T 09	'Rr. Barikadave, Tiranë	380
65	Bashkia Tiranë T 10	'Rr. Bogdanëve, Tiranë	382
66	Bashkia Tiranë T 11	'Rr. Gjergj Legisi, Tiranë	383
67	Bashkia Kamëz	'Rruga "Bulevardi Blu", Nr. 492, Kamëz, Tiranë	384
68	Bashkia Vorë	'Rr.Unaza, Nd.Nr. 73, Vorë, Tiranë	386
69	Bashkia Tiranë T 12 - Fresku	'Rr. Abaz Dojaka, Pall. MGB II sh.p.k, Lagja 12, Tiranë	3901
70	Njësia Adm. Farkë	'Rr.Rezervat e Shtetit, pranë Postës së Policisë Lundër,Kodi Postar 1045, Tiranë	391
71	Njësia Adm. Kashar	'Rruga "Loçka",Nd.Nr. 49,Yrshek, Kashar, Tiranë	392
72	Bashkia Tiranë T 14 - Astir	'Rr. Mikel Maruli, Lagja 14,Nd.Nr.2, Kodi Postar.1050,Yzberisht, Kashar, Tiranë	3921
73	Njësia Adm. Paskuqan	'Rr.Demokracia, Lagja.Babrru-Qendër, Paskuqan, Tiranë	394
74	Bashkia Kavajë	'Rruga e Tabakëve, Ish shkolla Dituria, Lagja 4, Kavajë	404
75	Bashkia Rrogozhinë	'Lagja nr.1, Bulevardi Kryesor Rrogozhinë, Kavajë,Bashkia Vjetër	405
76	Bashkia Vlorë	'Bulevardi Ismail Qemali, Pallati pranë Conad - ish OSHEE, Vlorë	415
77	Bashkia Himarë	'Spile, Himarë	420
78	Njësia Adm. Orikum	'Bulevardi "Princesha Rugjinë" Orikum, Vlorë	421
79	Njësia Adm. Novoselë	'Rruga e vjetër nacionale Vlorë-Fier, Novoselë, Vlorë	427
80	Bashkia Sarandë	'Lagja Nr 2, Rruga "Abedin Dino", Sarandë	433
81	Njësia Adm. Ksamil	'Rruga "Mësonjtorja", pranë shkollës "5 Dëshmorët", Ksamil	438
82	Bashkia Delvinë	'Rruga "Nazif Hadëri" Delvinë, Vlorë	444
83	Policia Berat	'Drejtoria Vendore e Policisë Berat, Lagja 30 Vjetori, Rr.Sotir Kolea, Berat	9001
84	Policia Çorovodë	'Komisariati i Policisë Çorovodë, Rr.Mestan Ujaniku, Çorovodë	9002
85	Policia Peshkopi	'Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, Rr. Iljaz Pash Dibra, Lagja Gjok Doçi, Peshkopi	9003

86	Policia Burrel	'Komisariati i Policisë Burrel, Rr. Pirustet, Lagja Pjeter Budi, Burrel	9004
87	Policia Durrës	'Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, Lagja Nr.8, Rr. Aleksandër Goga, Durrës	9005
88	Policia Elbasan	'Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, Lagja Kongresi Elbasanit, Rr.Koço Brisku, Elbasan	9007
89	Policia Gramsh	'Drejtoria Vendore e Policisë Gramsh, Lagja 18 Gushti, Rr.Xhile Liçi, Gramsh	9008
90	Policia Librazhd	'Komisariati i Policisë Librazhd, Rr. Jakup Biçaku, Nd.Nr.4, Librazhd	9009
91	Policia Fier	'Drejtoria Vendore e Policisë Fier, Rr. Koço Plaku, Lagjia 1 Maj, Fier	9010
92	Policia Lushnje	'Komisariati i Policisë Lushnje, Lagja Çlirimi, Lushnje	9011
93	Policia Gjirokastrë	'Drejtoria Vendore e Policisë, Bulevardi 18 shtatori, Gjirokastrë	9013
94	Policia Përmet	'Komisariati i Policisë Përmet, Rr.Meleq Gosnishti, Përmet	9014
95	Policia Korçë	'Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, Lagja 7, Rr. Floresha Myteveli, Korçë	9015
96	Policia Pogradec	'Komisariati i Policisë Pogradec, Rr.Dëshmorët e Pojskës,Nd.Nr.10 Pogradec	9016
97	Policia Kukës	'Drejtoria Vendore e Policisë Kukës, Rr. Sul Elezi, Kukës	9017
98	Policia Bajram Curri	'Drejtoria Vendore e Policisë B. Curri, Lagjia Partizani , Rr. Jaho Saliu, B. Curri	9018
99	Policia Lezhë	'Komisariati i Policisë Lezhë, Rr. Luigj Gurakuqi, Lezhë	9019
100	Policia Rrëshen	'Komisariati i Policisë Rrëshen, Rr. Musine Kokalari, Rrëshen	9020
101	Policia Shkodër	'Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, Rr.Lëvizja e Postribës, Shkodër	9021
102	Policia Pukë	'Komisariati i Policisë Pukë Rr. Ymer Puka, Pukë	9022
103	Policia Tiranë	'Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, Rr. Sami Frashëri , Nr. 5, Tiranë	9023
104	Policia Kavajë	'Komisariati i Policisë Kavajë,Rr. Osma Fazlliu, Kavajë	9029
105	Policia Vlorë	'Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, Rr. Rakip Malile, Lagjia Kushtrimi, Vlorë	9030
106	Policia Sarandë	'Komisariati i Policisë Sarandë, Rr.Vangjel Pandi,Lagja Nr.2, Sarandë	9031
107	Policia Laç	'Komisariati i Policisë Kurbin, Rruga Nacionale, Lagjia Nr 3, Kurbin	9032
108	DVKM Tiranë	'Reparti FNSH, Rruga Llazi Miho, Kombinat, Tiranë	8060
109	DVKM Durrës	'Rr. Tregtare, Lagjia Nr.1, Port, Durrës	8010
110	DVKM Vlorë	'Porti Vlorë	8070
111	DVKM Gjirokastrë	'Rr. Gerhot, Gjirokastrë	8020
112	DVKM Korçë	'Bulevardi Republika Lagja.1, Korçë	8030
113	DVKM Kukës	'Rruga Kukës-Bicaj Kilometri i parë	8040
114	DVKM Shkodër	'Ura e Bunës, Shkodër	8050
115	DVKM Sarandë	'Porti Sarandë	8071

Table 1 Adresat e Zyrave te Aplikimit

Nr.	Emri i Zyrës	Kodi i Zyrës	Lat.	Lng.
1	Bashkia Berat	2	40.77357	19.87866
2	Bashkia Ura Vajgurore	5	40.77358	19.87868
3	Bashkia Kuçovë	17	40.80508	19.91516
4	Bashkia Çorovodë	21	40.50487	20.22561
5	Bashkia Poliçan	22	40.61324	20.0977
6	Bashkia Peshkopi	32	41.68513	20.42767
7	Njësia Adm. Maqellarë	40	41.58851	20.4861
8	Bashkia Burrel	48	41.61107	20.01442
9	Bashkia Klos	49	41.50399	20.08877
10	Bashkia Bulqizë	61	41.49175	20.21874
11	Bashkia Durrës R 03	72	41.32145	19.44871
12	Bashkia Durrës R 04	73	41.32371	19.44485
13	Bashkia Durrës R 05	74	41.31877	19.45694
14	Bashkia Durrës R 06	741	41.33259	19.4702
15	Njësia Adm. Sukth	76	41.37113	19.54835
16	Njësia Adm. Xhafzotaj	83	41.34397	19.55425
17	Bashkia Krujë	85	41.51056	19.79207
18	Njësia Adm. Fushë-Krujë	86	41.47819	19.72236
19	Bashkia Elbasan	92	41.11415	20.08336
20	Bashkia Cërrik	97	41.0276	19.98998
21	Bashkia Belsh	98	40.98194	19.8907
22	Bashkia Gramsh	120	40.8688	20.18426
23	Bashkia Peqin	131	41.04566	19.75078
24	Bashkia Librazhd	138	41.1797	20.31414
25	Bashkia Prrenjas	139	41.07201	20.55226
26	Bashkia Fier	150	40.72972	19.55378
27	Bashkia Patos	154	40.68186	19.62705
28	Bashkia Roskovec	155	40.73815	19.70319
29	Bashkia Lushnje	171	40.94255	19.70357
30	Bashkia Divjakë	173	40.99361	19.53108
31	Njësia Adm. Fier-Shegan	178	40.86918	19.78272
32	Bashkia Ballsh	189	40.60235	19.73443
33	Bashkia Gjirokastër	199	40.07408	20.13733
34	Bashkia Tepelenë	213	40.29661	20.02058
35	Bashkia Përmet	224	40.23319	20.35299
36	Bashkia Korçë	234	40.61748	20.77866
37	Bashkia Maliq	238	40.70798	20.69971
38	Njësia Adm. Qendër-Korçë	248	40.65875	20.75728
39	Bashkia Ersekë	254	40.33889	20.68092
40	Bashkia Pogradec	263	40.90271	20.65695
41	Njësia Adm. Buçimas	264	40.89225	20.68166
42	Bashkia Bilisht	272	40.62493	20.98696
43	Bashkia Kukës	278	42.0777303	20.4161647

44	Bashkia Krumë	294	42.19777	20.41383
45	Bashkia B. Curri	299	42.35694	20.07405
46	Bashkia Lezhë	308	41.77981405	19.64394507
47	Njësia Adm. Shënkoll	316	41.69156	19.65236
48	Bashkia Rrëshen	319	41.76798	19.87514
49	Bashkia Laç	327	41.63591	19.71274
50	Njësia Adm. Mamurras	328	41.57987	19.69224
51	Bashkia Shkodër	332	42.06476	19.51068
52	Bashkia Vau i Dejës	336	42.00917	19.64001
53	Njësia Adm. Bushat	338	41.95775	19.53249
54	Njësia Adm. Postrribë	344	42.11314	19.57301
55	Bashkia Pukë	354	42.04436	19.90023
56	Bashkia Koplik	365	42.21008	19.43831
57	Bashkia Tiranë T 01	373	41.328381	19.83308
58	Bashkia Tiranë T 02	374	41.32589	19.83038
59	Bashkia Tiranë T 03 - T 04	375	41.33767	19.83517
60	Bashkia Tiranë T 05	377	41.31803	19.80246
61	Bashkia Tiranë T 13 - K. Diellit	3771	41.31173	19.80026
62	Bashkia Tiranë T 06	378	41.31454	19.76657
63	Bashkia Tiranë T 07	379	41.32409	19.80054
64	Bashkia Tiranë T 08 - T 09	380	41.3311	19.82013
65	Bashkia Tiranë T 10	382	41.32919	19.80931
66	Bashkia Tiranë T 11	383	41.33921	19.79505
67	Bashkia Kamëz	384	41.38394	19.76089
68	Bashkia Vorë	386	41.39129	19.65648
69	Bashkia Tiranë T 12 - Fresku	3901	41.34835	19.85372
70	Njësia Adm. Farkë	391	41.27811	19.8627
71	Njësia Adm. Kashar	392	41.34664	19.75019
72	Bashkia Tiranë T 14 - Astir	3921	41.33175	19.78097
73	Njësia Adm. Paskuqan	394	41.35364	19.82633
74	Bashkia Kavajë	404	41.1843	19.56277
75	Bashkia Rrogozhinë	405	41.07642	19.664
76	Bashkia Vlorë	415	40.46356	19.48913
77	Bashkia Himarë	420	40.10246	19.74397
78	Njësia Adm. Orikum	421	40.32613	19.47154
79	Njësia Adm. Novoselë	427	40.62215	19.46962
80	Bashkia Sarandë	433	39.87398	20.00358
81	Njësia Adm. Ksamil	438	39.77084	20.00255
82	Bashkia Delvinë	444	39.95135	20.1038
83	Policia Berat	9001	40.70073	19.96047
84	Policia Çorovodë	9002	40.50365	20.22872
85	Policia Peshkopi	9003	41.68211	20.42436
86	Policia Burrel	9004	41.60829	20.01503
87	Policia Durrës	9005	41.32439	19.4451
88	Policia Elbasan	9007	41.11635	20.08501

89	Policia Gramsh	9008	40.86791	20.18478
90	Policia Librazhd	9009	41.18031	20.31534
91	Policia Fier	9010	40.71759	19.57109
92	Policia Lushnje	9011	40.94437	19.70414
93	Policia Gjirokastrë	9013	40.08249	20.14145
94	Policia Përmet	9014	40.23205	20.35525
95	Policia Korçë	9015	40.61545	20.77633
96	Policia Pogradec	9016	40.90202	20.66062
97	Policia Kukës	9017	42.07283	20.42322
98	Policia Bajram Curri	9018	42.3577	20.07205
99	Policia Lezhë	9019	41.77865	19.64373
100	Policia Rrëshen	9020	41.76948	19.87503
101	Policia Shkodër	9021	42.0792	19.52288
102	Policia Pukë	9022	42.04688	19.89605
103	Policia Tiranë	9023	41.32404	19.81308
104	Policia Kavajë	9029	41.18813	19.56199
105	Policia Vlorë	9030	40.47731	19.487513
106	Policia Sarandë	9031	39.87738	20.00561
107	Policia Laç	9032	41.63858	19.711803
108	DVKM Tiranë	8060	41.30574001	19.75601946
109	DVKM Durrës	8010	41.31645	19.45492
110	DVKM Vlorë	8070	40.45193	19.48367
111	DVKM Gjirokastrë	8020	40.08999	20.1351
112	DVKM Korçë	8030	40.62167	20.78326
113	DVKM Kukës	8040	42.03838	20.41882
114	DVKM Shkodër	8050	42.05243	19.48807
115	DVKM Sarandë	8071	39.87144	20.00301

Table 2 Koordinatat gjeografike për çdo Zyre Aplikimi

Kriteret Teknike për shërbimin Data për Zyrat e Aplikimit:

Linjë e Dedikuar të Dhënash Intranet:

- Kapaciteti: Simetrik 20 Mbps/20 Mbps minimalisht
- Teknologjia: Media Trasmetimi nga Zyra Qëndrore Identitek tek secila Zyre Aplikimi.
- Besueshmëria: CIR 99.95% me redundancë të plotë.
- Shërbimi: Duhet të suportojë IPsec VPN Ikev2 (Certificate Authentication) dhe filtër MAC për siguri.

Shërbimi Primarë për të Dhënat Intranet:

- Lidhje Redundate: Të dyja lidhjet, primare dhe backup, duhet të përfundojnë në pika të ndara prezence (POP) për redundancë maksimale.
- Failover Automatik: Të sigurohet failover automatik midis fibrës optike primare

dhe medias për shërbimin rezervë për shërbim të pandërprerë më anë të mekanizmave PBR Automatic Failover.

Kërkesa Funksionale:

- Platformë e menaxhimit të qëndrësuar për monitorim dhe raportim në kohë reale.
- Trafiku i pakufizuar për shërbimin intranet, me mbështetje për IPsec VPN.
- Terminimi në Zyrtat e Aplikimit të bëhet me:
 - Pajisje që mundesohen nga Ofruesi
 - Mundësia e Konfigurimit duhet të jetë Wan redundant me Primar / Sekondar me Vlan të dedikuar Primary data / Secondary Data
 - Menaxhim dhe Monitorim të qëndrësuar të pajisjeve
- Trafiku Shërbim Data duhet të jetë pa limit
- Të Suportojë dhe të Garantojë teknologjinë - IPsec VPN
- Të Suportojë dhe të Garantojë Mekanizmin - Mac Filter (Bllokimin e Aksesit për Stacione Aplikimi të Paautorizuara)

Kritere Funksionale të shërbimit për Zyrtat e Aplikimit:

- Të mundësojë Platformë Menaxhimi dhe Sistem Kontrolli të qëndrësuar për Pajisjet e Zyrave të Aplikimit
- Të plotësojë kërkesat e reja për Shërbim Intranet Data për Zyrtat e Aplikimit
- Të garantojë kërkesat për relokim të Zyrave ekzistuese apo dhe të reja të Aplikimit
- Të garantojë stokun e mjaftueshëm me Pajisje përgjatë gjithë vlefshmërisë së Kontratës

Operatori ekonomik duhet të mundësojë për Shërbimin:

- Grafike dhe raporte në kohë reale të trafikut në rrjet
- Monitorim të protokolleve në rrjet
- Njoftime automatike dhe alarmistike sipas templateve të konfigurueshme edhe nga vetë AK
- Dashboarde të përdorimit të shërbimit të konfigurueshme edhe nga vetë AK
- Vendosje të objektivave të shërbimit dhe parametrave threshold me qëllim përcaktimin dhe monitorimin e Service Level Agreement
- Raportim online të performancës së Shërbimit në rrjet dhe SLA
- Mundësi për përdorim të protokolleve SNMP, Netflow, sFlow për monitorimin e performancës së Shërbimeve në rrjet
- Mbrojtje të rrjetit të AK përmes parandalimit të ndërhyrjeve nga sulmet DOS dhe DDOS.

Ofruesi i Shërbimit duhet:

- Të plotësojë kërkesat e reja për Shërbim Data për Zyrtat e Aplikimit
- Të garantojë kërkesat për zhvendosje të Zyrave ekzistuese apo dhe të reja të Aplikimit
- Të garantojë shërbimin 24/7.

- Të krijojë dhe të garantojë brënda rrjetit të tij, një rrjet apo qark virtual për AK që do të izolojë trafikun nga pjesa tjetër e këtij rrjeti. Gjithashtu, rrjeti i ofruesit duhet të jetë transparent ndaj trafikut të AK-së dhe ta udhëzojë atë në shtresat e ulëta të protokolleve të komunikimit.
- Rrjeti i OE nuk duhet të shkaktojë asnjë varësi në Network Layer për përdoruesin.
- OE duhet të vërtetojë se shërbimet që ofron janë të bazuara në rrjeta me kapacitete të mjaftueshme për të garantuar gjerësitë e brezave të kërkuara të lidhjes dhe trafikun e kërkuar nga AK.
- OE duhet të garantojë qëndrueshmëri shërbimi min 99.95% (Service Availability). Kohët e ndërprerjes do të jenë objekt i sanksioneve që do të përcaktohen në kontratë.
- Kohë-vonesat e kthimit të paketave test (ping Round Trip Time) për një qark lokal të pangarkuar kërkojnë të jenë më të vogla se 10 ms. Jitter jo më shumë se 20 ms.
- OE duhet të paraqesë me anën e një grafiku dhe me përshkrimet përkatëse skemën llogjike të implementimit dhe zgjidhjes për secilën degë. Skema duhet të përmbajë mënyrën e lidhjes për të gjitha Deget dhe CPE-te për secilën degë.
- Pajisjet CPE duhet të kenë certifikim CE
- OE duhet të instalojë dhe të vërë në punë pajisjet terminuese CPE të lidhjes midis tij dhe rrjetave të AK-së
- OE duhet të sigurojë monitorim të pajisjeve të tij fundore në kohë reale 24/7 si dhe të ofrojë mbështetje për njoftim problemesh (helpdesk) sistem që duhet të monitorojë rrjetin vazhdimisht 24/7/365.
- Sistemi i monitorimit duhet të jetë në gjendje të identifikojë sulmet në rrjet, ndërprerjet e shërbimit, kalimet e limiteve në vonesa, humbjet e paketave, kalimet në jitter, konfliktet e MAC adresave dhe IP adresave.
- Sistemi duhet të gjenerojë grafikë, tabela dhe raporte mbi bazë kohore për rrjetin në përgjithësi dhe për çdo element të rrjetit.
- Personeli i AK-se duhet të njoftohet në raste defektesh. Në mënyrë të veçantë, në rastet e padisponueshmërisë ose paqëndrueshmërisë së rrjetit për një periudhë kohe më të madhe se 30 minuta, Ofertuesi duhet të njoftojë personat përgjegjës në AK me e-mail, telefon ose SMS.
- Operatori ekonomik, bazuar në përforcimin e procedurave të sigurisë, duhet të gjenerojë në mënyrë periodike 1 (një) mujore dhe të dorëzojë raportet mbi Shkallën e Sigurisë Kibernetike të Rrjetit dhe shërbimeve që ofron për klientin AK. Një template i këtij raporti duhet paraqitur në propozimin teknik.
- Në të gjitha pikat e mësipërme ku do të lidhet shërbimi i kërkuar, gjatë periudhës së ofrimit të shërbimit, operatori ekonomik duhet të vërë në dispozicion pajisjet shoqëruese (Router, switchet, kabëll cat5e, cat6, fibër optike etj.)
- Dokumentimi i lidhjeve dhe shërbimeve
 - OE duhet të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm si mëposhtë:
 - Skemat e detajuara të lidhjeve
 - Udhëzues për diagnostifikim dhe troubleshooting
 - Një dokument për zgjidhjen e problemeve tipike.
- Konfidencialiteti dhe siguria
 - OE duhet të garantojë konfidencialitetin dhe sigurinë në transmetimin e informacionit nga AK dhe anasjelltas.
 - Mbrotjtja e trafikut në rrjetin Internet dhe Intranet.

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë një infrastrukturë për shtrirjen e rrjetit me mbulim në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke vërtetuar kështu kapacitetin e Operatorit Ekonomik për realizimin e Shërbimit.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e plotë të zgjidhjes teknike për ofrimin e shërbimit të kërkuar, në të cilën duhet të përshkruhen qartësisht:

- Skemat e detajuara të lidhjeve
- Udhëzimet për diagnostifikim dhe troubleshooting
- Propozimi për zgjidhjen e problemeve tipike sipas kërkesave teknike të Autoritetit.

Operatori duhet të ofrojë shërbimin “Help Desk”. Ky shërbim konsiston në mirëmbajtjen e rrjetit, asistencë online për të gjithë problemet me rrjetin. Shërbimi Help Desk duhet të jetë i kontaktueshëm nga stafi i Identitek 24/7. Për këtë operatori duhet të paraqesë dëshmi të shërbimit të monitorimit 24/7.

Konstatimi dhe riparimi i difekteve në linjë dhe/ose në pajisje që mundësojnë ofrimin e këtij shërbimi brenda afateve të mëposhtme:

- Koha e përgjigjes duhet të jetë brenda 10 minutash.
- Koha e zgjidhjes së problemit në të gjithë rrjetin duhet të jetë brenda 2 orësh.
- Mbështetje aktive deri në zgjidhjen e problemit.

Disponueshmëria

Disponueshmëria e linjës nuk duhet të jetë nën >99.95% në baza mujore. Disponueshmëria mujore do të llogaritet si më poshtë:

$$\text{Disponueshmëria} = \frac{[\text{Koha Totale}] - [\text{Koha Jo Funksionale}]}{[\text{Koha Totale}] \times [\text{Koha Totale}]}$$

= [ore] x [ditë kalendarike] për çdo muaj.

Operatori ekonomik oferton duke u siguruar që kupton qartë zgjidhjen teknike të kërkuar

Standarte dhe Referenca :

Standardet e Rrjetit Kompjuterik

- Standardet për Shërbimin e Internetit

- -IEEE 802.3 (Standardet Ethernet)**: Rregullon lidhjet Ethernet me kablllo, duke përfshirë ndërfaqet Gigabit Ethernet (GbE) të specifikuara për lidhjen me rrjetin LAN të Identitek.
- -ITU-T G.652/G.657: Standardet për fibra optike me një modë, duke siguruar pajtueshmëri dhe performancë për lidhjen me fibra optike të specifikuar në zgjidhje.
- -RFC 791 (IPv4) dhe RFC 8200 (IPv6): Standardet e Protokollit të Internetit (IP), që përcaktojnë adresimin dhe drejtimin e përdorur në zgjidhje, veçanërisht për ofrimin e IP-ve publike.
- -BGP (RFC 4271): Standardi i protokollit Border Gateway Protocol, i nevojshëm për failover automatik dhe balancim të ngarkesës midis ASN-ve.

Standardet për Intranet dhe VPN

- IEEE 802.1Q: Standard për VLAN, që siguron segmentimin e rrjetit për trafik të sigurt dhe efikas të të dhënave, siç përmendet në kërkesat për konfigurimin VLAN.

- IPsec (RFC 4301): Korniza e sigurisë për VPN, që mundëson enkriptim dhe komunikim të sigurt për shërbimin e të dhënave në intranet.

Standardet e Sigurisë

- -DNSSEC (RFC 4033, 4034, 4035): Standardet për Zgjerimet e Sigurisë në Domain Name System (DNS), që sigurojnë validim kriptografik të kërkesave dhe përgjigjeve DNS.
- -ISO/IEC 27033: Udhëzime për lidhjet e sigurta të rrjetit, duke adresuar rreziqet e sigurisë dhe masat për të parandaluar shkeljet e të dhënave.
- -NIST SP 800-77: Udhëzues për sigurinë e IPsec VPN, që siguron konfigurime dhe zbatime të sigurta.
 - RFC 4987: Teknikat për mbrojtjen kundër sulmeve të shërbimeve të mohuara (DOS) dhe shërbimeve të shpërndara të mohuara (DDOS).

Standardet për SLA (Marrëveshje për Nivelin e Shërbimit) dhe QoS (Cilësia e Shërbimit)

- -ITU-T Y.1541: Përcakton objektivat e performancës së rrjetit për shërbimet IP, përfshirë vonesat, luhatjet dhe humbjet e paketave.
- -ISO/IEC 20000-1: Standardi për menaxhimin e shërbimeve që përcakton kërkesat për krijimin dhe mbajtjen e ofrimit të shërbimeve me cilësi të lartë.
- -MEF CE 2.0: Standardi për Ethernet-in e Ofruesve të Shërbimit, që siguron lidhje interneti dhe intraneti të shpejtë, të besueshëm dhe të sigurt.

Standardet për Redundancë dhe Disponueshmëri të Lartë

- -ISO/IEC 24762: Udhëzime për redundancë dhe shërbime për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë, të zbatueshme për mekanizmat e failover-it dhe backup-it për shërbimet e internetit dhe intranetit.
- -ITU-T G.8032: Standardi për mbrojtjen e rrathëve Ethernet, që siguron një arkitekturë të qëndrueshme rrjeti.
- -BGP Failover Best Practices (RFC 7947): Rekomandime për konfigurimin dhe menaxhimin e failover-it midis ASN-ve të shumfishta.

Standardet për Monitorim dhe Raportim

- -SNMP (RFC 1157): Protokoll i Menaxhimit të Rrjetit të Thjeshtë për monitorimin në kohë reale të rrjetit.
 - NetFlow (RFC 3954) dhe sFlow: Standardet për monitorimin e trafikut të rrjetit të bazuar në rrjedhje, siç kërkohet për raportimin e SLA-së dhe analizën.
 - ISO/IEC 27002: Teknikat e sigurisë për monitorimin e aktiviteteve të rrjetit dhe gjenerimin e raporteve periodike të sigurisë kibernetike.

Standardet për Shtresën Fizike

- -TIA-568 (Kablime të Strukturuar): Standardet për instalimin e kabllave me fibra optike, duke siguruar besueshmërinë e lidhjeve fizike.
 - EN 50173: Standardet evropiane për infrastrukturën ICT në ndërtesa, të zbatueshme për qendrat e të dhënave dhe instalimet në zyrë.

Standardet për Sigurinë Kibernetike

- -ISO/IEC 27001: Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit për të siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e shërbimeve të rrjetit.
- -NIST Cybersecurity Framework (CSF): Korniza për identifikimin, mbrojtjen, zbulimin, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga incidentet kibernetike.

Afati kohor i Implementimit – Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) diteve nga nënshkrimi i kontratës.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**Shërbimi që kërkohet:**

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
1.	Shërbim Primar Internkoneksioni për Zyrën Qëndrore Identitek	1	Zyrat Qendore “Identitek” SHA	
2.	Shërbim Primar Internkoneksioni për Zyrat e Aplikimeve Identitek	115	Zyrat e aplikimit nëper rrethe sipas tabelës në Shtojcën nr. 6 “Specifikimet Teknike”	

Afatet e ekzekutimit: Do të jetë nga momenti i nënshkrimit të kontratës/kontratave, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 12 (dymbëdhjetë) muaj nga lidhja e Marrëveshjes Kuadër.

Afati kohor i Implementimit – Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) diteve nga nënshkrimi i kontratës.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

1. Qellimi

IDENTITEK” SH.A. është një shoqëri me kapital 100% shtetëror, me objekt veprimtarie prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit (ID) dhe pasaportave biometrike për shtetasit shqiptarë. Ne menyre qe te garantoje kete veprimtari eshte e rendesishme qe te siguroje nje sherbim te persosur dhe te sigurte Linje primare internet dhe intranet per zyren qendrore dhe zyrat e aplikimeve.

2. Pershkrimi i Sherbimit te kerkuar

Identitek sha kerkon qe te gjithe operatorete qe do marrin pjese ne proceduren konkurruese duhet te plotesojne nje sere kushtesh teknike per ofrimin e sherbimit sipas kriterave te me poshtme :

Nr.	Lloji i Shërbimit	Përshkrimi	Sasia	Afati Kohor
1.	Shërbim Primar Internkoneksioni për Zyrën Qëndrore Identitek	Sherbim Interneti i Dedikuar Primar me ASN dhe IP Publike të dedikuar	1	1 Vjekar
2.	Shërbim Primar Internkoneksioni për Zyrat e Aplikimeve Identitek	Shërbim Primar Intranet Data	115	1 Vjekar

Vendi i kryerjes së shërbimit: Në ambjentet e zyrave qendrore të “IdentiTek” SHA dhe zyrave të aplikimit neper rrethe, te percaktuara ne menyre te detajuar ne Shtojcen nr.6 “Specifikimet Teknike.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

